**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 15, datë 31.01.2023

## PËR
## MIRATIMIN E NJË SHTESE DHE NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.142, DATË 24.11.2022 NË LIDHJE ME VENDBAZIMET E MJETEVE LUNDRUESE

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 43/2020, "Për aktivitetet e turizimit tregtar"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativë-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore" si dhe sipas relacionit teknik të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin me nr. 462, datë 14.09.2022, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese dhe ndryshimi në VKB-në nr.142, datë 24.11.2022 në lidhje me vendbazimet e mjeteve lundruese sipas hartës bashkëngjitur, si më poshtë vijon:

    a. Vendbazimi me kordinatat; Lindje: 459466.975 m, Veri: 4570924.386 m spostohet në kordinatat: Lindje: 459521.555 m, Veri: 4570703.015 m.

    b. Shtohet vendbazimi me kordinatat: Lindje: 455538.003 m, Veri: 4575655.717 m.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 02.02.2023**




*mi koordinativ: KRGJSH*
*ktimi: KRGJSH*

SH 1:1,200
0 12.5 25 50 m

Punoi:
Ervis BAHITI

vendbazim perballe "Hotel Amara"




...mi koordinativ: KRGJSH
...ktimi: KRGJSH

SH 1:1,000
0 10 20 40 m

Punoi:
Ervis BAHITI

09/02/23 273/5

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 85/3 prot. Durrës, më 09.02.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.15 datë 31.01.2023 "Për miratimin e një shtese dhe ndryshimi në VKB nr 142 dt 24.11.2022 në lidhje me vendbazimet e mjeteve lundruese".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS